




REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. <u>2-D/DPK</u>	Nr. Prot. Br. Prot. <u>01-1944/15</u> Prot No.
Nr. ifaq. Shën. shifra Nr. datës <u>02</u>	Data Datum <u>14-07-2015</u> Date
PRISHTINE	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATE/A:	14/07/2015
REFERENC-Ë:	AKK-DPKPP
PËR/ZA/TO:	z. Hasim KRASNIQI Zyrtar Kryesor i Prokurimit
CC:	z. Sejdi HOXHA Kryeshef ekzekutiv i Postës së Kosovës SH.A
NGA/OD/FROM:	z. Hasan PRETENI Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me Tenderin "Larja e automjeteve të PK-sh.a-Ritender 3 "



I nderuari z. Krasniqi,

Duke u bazuar në nenin 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.12 të Ligjit për Agjencinë kundër Korrupsionit nr.03/L-159 dhe nenin 19 paragrafi 1, nën paragrafi 1.6 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, lidhur me tenderin "Larja e automjeteve të PK-sh.a-Ritender 3 "me nr. të prokurimit: PK 15 032 236, Agjencia kundër Korrupsionit ofron këtë:

OPINION

Kërkohet nga ju si autoritet kontraktues (në tekstin e mëtejme A.K), që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme për evitimin e shkeljeve të evidentuara në lidhje me tenderin "Larja e automjeteve të PK-sh.a-Ritender 3 " në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit nr.04 – L/042 për Prokurimin Publik.

A r s y e t i m

Departamenti i Prokurimit në Postën e Kosovës ka përgatitë “ Njoftimin për Kontratë ” me titull “ Larja e automjeteve të PK-sh.a-Ritender 3 “ me nr. prokurimi: PK 15 032 236, e cila është publikuar në faqen elektronike të KRPP-së me dt. 02.07.2015. Agjencia Kundër Korrupsionit sipas detyrës zyrtare ka identifikuar këtë aktivitet prokurimi si rast për trajtim. Gjatë ekzaminimit të këtij aktiviteti të prokurimit në “Njoftimin për Kontratë”, Agjencia Kundër Korrupsionit ka hasur në disa të dhëna që nuk janë në pajtueshmëri të plotë me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës.

Në Njoftimin për Kontratë të publikuar në faqen elektronike të KRPP-së, më datë 02.07.2015, tek pika III.2.4 e rubrikës “Kapaciteti teknik dhe profesional”, pika 5. është kërkuar selia e Operatorit Ekonomik nuk munde të jetë me largësi se 5 km nga qyteti i Prishtinës , gjithashtu e njëjta pikë është përshkruar edhe në Dosjen e Tenderit , që ka përgatitur A.K për këtë tender , pikë kjo e cila konsiderojmë se bie ndesh me ligjin në fuqi për Prokurimin Publik.

Autoriteti Kontraktues Posta e Kosovës me formulimin e këtij kriteri tek pika 5 e Njoftimit për Kontratë dhe Dosjes së Tenderit, ka bërë Diskriminim territorial në kundërshtim me Ligjin në fuqi për Prokurimin Publik ku thuhet se “Autoriteti Kontraktues nuk do të krijojë ose imponojë dhe do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar krijimin ose imponimin e rrethanave ose kushteve që rezultojnë në diskriminim territorial, fizik, material, personal ose organizativ ndërmjet operatorëve ekonomik“, duke i diskriminuar Operatorët Ekonomik që janë në largësi më tepër se 5 km favorizohen Operatorët Ekonomik që janë më afër se 5 km. Kjo ndërlihet edhe me faktin se ky aktivitet i prokurimit është anuluar për herën e tretë për shkak të numrit të pamjaftueshëm të Operatorëve Ekonomik të cilët kanë dorëzuar Dosjen e Tenderit për këtë aktivitet të prokurimit, ku edhe në Njoftimin për Anulimin e Aktivitetit të Prokurimit të publikuar me datë 09.07.2015 në web faqen e KRPP-së, arsyeja e anulimit të procedurës së prokurimit publik është se janë pranuar vetëm dy tenderë.

AKK-Posta e Kosovës këtë aktivitet të prokurimit e ka para në procedurën Koutim të Çmimit me kohëzgjatje të kontratës prej 24 muaj, sipas LPP Autoriteti kontraktues mund të përdorë procedurat për Koutimin e çmimeve për të ushtrua një aktivitet të prokurimit që ka për qëllim dhënien e një kontrate të punëve furnizimeve ose shërbimeve , mallrat ose shërbimet përkatëse nuk ka nevojë të prodhohen ose përpunohen posaçërisht në mënyrë që t'i përmbushin kërkesat e autoritetit kontraktues, po ashtu tek pjesa Seksioni II. Formulari i përshkrimit të çmimit e dosjes së tenderit Autoriteti Kontraktues ka parapa Sasi të përafërt të larjes së veturave, pike e cila bie në kundërshtim me pikën 5 të formularit të paraqitjes së Koutimit të Çmimit ku thuhet: Çmimi i përgjithshëm i kuotuar është fiks dhe nuk i nënshtrohet ndonjë ndryshimi gjatë kontratës (duke përjashtuar çmimet e këtyre artikujve që janë subjekt i rregullimeve të çmimeve në bazë të shkëmbimit të aksioneve përkatëse). Çmimi i përgjithshëm i kuotuar specifikohet dhe është i bashkangjitur në Specifikimet e Çmimit.

Veprimet e Autoritetit Kontraktues konsiderojmë se bien ndesh me, nenin 7 Barazia në Trajtim Jo-Diskriminimi të Ligjit për Prokurimin Publik Nr.04/L-042.

Konsiderojmë se shkelje të tilla, nuk duhet lejuar në procedura të prokurimit, andaj AKK rekomandon të shmangen praktika të tilla në të ardhmen.

Me respekt !